



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1972

NR. VENDIMI 2003



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

Nr.	1972	Akti
Nr. 2003 Vendimi		
Data	e	regjistrimit
Data e vendimit 30.06.2021		12.04.2021

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

**GJYQTARE: ARMELA HASANTARI**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Berzana Çobo**, sot më datë 30.06.2021, pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale Nr. 1972 Regjistri Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:**

**Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori **Ylli Bashaj**.

**I PANDEHUR:**

**Xhiljon Hoxha**, i biri i Skënder-it dhe i Jetë-s, i datëlindjes 30.06.1986, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Ali Baushi”, banese private tre kateshe , kati i dyte , ish posta sekrete Tirane, arsimi -8 klase, me gjendje civile i martuar me një fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i denuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, mbrojtur me deklaram ne seancë gjyqësore nga Av. Ilir Murati, me nr license 1216 dhe nr nipti K61912001V, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**AKUZUAR:**

Për kryerjen e vepres penale të **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, të parashikuar nga neni **283/1** i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Ylli Bashaj, në prani të pandehurit Xhiljon Hoxha, në prani të mbrojtësit të tij, Gjykata, pasi dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilat kërkuan:

**Prokurori:** Të deklarohet fajtor i pandehuri Xhiljon Hoxha për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, që parashikohet nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij sipas ligjit.

**Mbrojtësi i të pandehurit Xhiljon Hoxha** I kërkojmë Gjykatës që të vlerësojë disa rrethana në caktimin e llojit të dënimit si vijon: I pandehuri e pranon akuzën dhe ndjehet thellësisht i penduar; Sasia e lëndës narkotike gjetur në banesë është shumë e vogël; I pandehuri është përdorues i të dy lëndëve gjetur në banesë në sasira të vogla; Është kryefamiljar dhe i vetmi burim i sigurimit të minimumit jetik të familjes së tij; Ka në ngarkim një fëmijë të mitur 10 muajsh; Bashkëshortja e tij vijon studimet e larta, aktualisht është e papunë dhe pa praninë e bashkëshortit është e pamundur të sigurojë të ardhura për fëmijën e mitur; Sipas një vlerësimi shoqëror të dhënë nga ndërlidhësi me komunitetin, rezultoi se i pandehuri dhe familja e tij nuk kanë qenë problematik në komunitet. Në këto kushte kërkojmë nga Gjykata deklarimin fajtor të të pandehurit Xhiljon Hoxha për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, sipas nenit 283/1 të K.Penal dhe dënimin e tij në minimumin e parashikuar në ligj si dhe pezullimin e pjesës së mbetur të dënimit me burgim në një afat kohor prove prej 2 vitesh.

## VËREN:

### **I. Rrethanat e faktit.**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për gjykimin e të pandehurit Xhiljon Hoxha, i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, parashikuar nga neni **283/1** i Kodit Penal. Me vendimin penal Nr. 854 datë 30.03.2021, Gjyqtari i Seancës Paraprake ka vendosur dërgimin e çështjes penale në gjyq në ngarkim të të pandehurve, së bashku me kërkesën e tyre për gjykim të shkurtuar.

2. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata, si vlerësoi se aktet e hetimeve paraprake ishin të plota, nuk kontestoheshin nga palët, si dhe nuk konstatohej pavlefshmëri absolute e tyre apo papërdorshmëri e provave, çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen që janë aktet, pa cënuar të drejtat dhe interesat e të pandehurve. Në këto kushte, në bazë të nenit 405/6 të K. Pr. Penale, gjykata vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe të procedojë me gjykim të shkurtuar.

3. Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe në prova të kërkesës së prokurorisë, gjykata mori në shqyrtim kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj kërkesë. Bazuar në nenet 69, 74 dhe 76, gjykata konstatoi se kërkesa objekt gjykimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të saj.

4. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të gjykimit rezultoi se:

4.1 Më datën 17.11.2020, grupi i specialistëve dhe ndihmës specialistëve të strukturës policore për hetimin e narkotikëve, pjesë e strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, i përbërë

nga shtetasit Maringlen Beqo, Dritan Sula, Anri Nazaj, Tomi Gramo, Abedin Metko, Xhuljo Nazëraj dhe Elton Daci, në kuadër të realizimit të planit të masave, të përpiluar për kontrollin e zonave të shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe kapjen e personave shpërndarës të këtyre lëndëve, janë planizuar për ta kryer këtë detyrë në rrugën " Ali Baushi". Kur kanë qenë në këtë territor, rreth orës 12 e 45', atyre ju ka rënë në sy prezenca e dy personave, njëri prej të cilëve është identifikuar si shtetasi Elton Tahiri, ndërsa tjetri, identifikimi i të cilit është bërë më vonë dhe ka rezultuar se ai ishte i pandehuri Xhiljon Hoxha. Është vënë re se personat në fjalë shkëmbyen diçka mes tyre, kur ata ishin pranë njëri tjetrit dhe pas këtij veprimi, shtetasi Elton Tahiri, është larguar në drejtim të rrugës "Xhanfize Keko". Dyshimet e krijuara për veprimtari të paligjshme të tyre, kanë nxitur pjestarët e grupit të ndërhyjnë, për të kapur e ndaluar këtë të fundit dhe pas ndalimit të tij, ai është kontrolluar në kushtet e flagrancës. Gjatë kontrollit, në xhepin e pantallonave, atij i është gjetur një qese plastike e mbështjellë, brenda të cilës, kishte lëndë që është dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë". Ky fakt ka shërbyer, që personi në fjalë, të shoqërohej në organin e policisë, ku edhe është pyetur për faktet e mësipërme dhe ka deklaruar se substancën e dyshuar si narkotike që konsiderohej sasia e një doze të lëndës narkotike e llojit "Heroinë", ai e kishte blerë me çmimin 800 lekë, tek i pandehuri Xhiljon Hoxha. Lënda e dyshuar si substancë narkotike, që i është gjetur me vete, është sekuestruar me cilësinë e provës materiale, e cila pas peshimit ka rezultuar në peshën 0,2 gram.

4.2 Në këto kushte, grupi i sipërpërmendur i punonjësve të policisë, ka shkuar në banesën e shtetasit Xhiljon Hoxha dhe pas kontaktit me këtë të fundit, ka hyrë në banesën e tij dhe ka kryer një kqyrje të hollësishme të ambienteve të saj. Fillimisht, në hyrje të banesës së tij është gjetur vetë shtetasi Xhiljon Hoxha, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij Anisa Hoxha, të cilëve ju është bërë me dije se, grupi përbëhej nga punonjës policie. Pas këtij komunikimi, shtetasi Xhiljon Hoxha ka pranuar menjëherë se kishte me vete lëndë narkotike. Gjatë kontrollit që ju bë atij në kushtet e flagrancës, i janë gjetur katër qese farmaceutike, me material bimor, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Cannabis Sattiva", të cilat pas peshimit, kanë rezultuar në masën 6,4 gram si dhe shtatë qese plastike, të mbyllura në formë dozash standarte, brenda të cilave kishte material të dyshuar si lëndë narkotike të llojit "Heroinë". Kjo e fundit, pas peshimit rezultoi në masën 3,4 gram. Gjithashtu në një paketë cigare, që shtetasi në fjalë kishte me vete, është gjetur edhe pak material bimor, i dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Cannabis Sattiva ", që mbas peshimit ka rezultuar në masën 0,6 gram.

**4.3 Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr. 1270 datë 03.02.2021 rezulton se, pesha e materialit bimor të përshkruar më sipër është 6,499 gram dhe materiali bimor është cannabis sattiva produkt herbal i bimës "Cannabis sattiva L"; Ndërsa sasia prej 1,892 gram material pluhur, tregonte për praninë e heroines".**

4.4 Pas këtij momenti, është shkuar në banesën e te pandehurit Xhiljon Hoxha dhe nga kqyrja e banesës së tij, janë evidentuar sasi të tjera të lëndëve të dyshuar si narkotike. Në ambientin e koridorit të banesës, mbrapa frigoriferit janë gjetur dy vazo qelqi, në njërin prej të cilave janë gjetur 18 qese farmaceutike, me material bimor, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Cannabis Sattiva", ndërsa në vazën tjetër është gjetur material i tillë, i dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Cannabis Sattiva", futur në një qese plastike. Pesha e materialit bimor që ndodhej në qeset e gjetura në të dy vazot arrinte sasinë 33,2 gram. Në vazhdim të kqyrjes, në parvazin e dritares së dhomës së ndenjes, është gjetur një kuti e bardhë me mbishkrimin "Metadon", brenda së cilës kishte 18,5 kokrra, të dyshuara si lëndë narkotike të llojit "Metadon", e që kishin një peshë

prej 2,8 gram. Ndërsa mbi një tavolinë, që ndodhej në dhomën e ngrënies, në një tabaka, është gjetur një kuti alumini, me mbishkrimin "Ginger" brenda së cilës kishte dy kartvizita si dhe mbetje të një pluhuri me ngjyrë dheu "i dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë". Materialet bimorë dhe pluhur, të dyshuar si lëndë narkotike, si dhe sendet tjera, të gjetura tek shtetasi Xhiljon Hoxha në banesën e tij, janë sekuestruar gjithashtu me cilësinë e provës.

4.5 Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr. 1634 të datës 15.02.2021 ka rezultuar se, *pesha e të gjitha materialit bimor të sekuestruar në ambientin tjetër të banesës e të përshkruar më sipër, i ambalazhuar në 19 paketime, është 32,6 gram dhe materiali bimor në fjalë është i llojit cannabis sativas, produkt herbal i bimës "cannabis sativas L".*

4.6 Njëpërmjet aktit të ekspertimit kimik Nr.1633 të datës 15.02.2021 mësohet se, *mbajtëset plastike kartë e kuqe etj, përmbajnë mbetje, që treguan praninë e heroinës. Ndërsa 17 tableta të vogla me ngjyrë të bardhë, treguan praninë e metadonit. Materiali bimor i cilësuar si Cannabis Sattiva, substanca heroinë janë klasifikuar si lëndë narkotike sipas ligjit Nr 7975 të datës 26.07.1995 " Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"*

4.7 Sipas aktit të ekspertimi toksikologjiko - ligjor Nr. 2522 datë 27.11.2020 i shtetasit Xhiljon Hoxha, *tregojnë se, në mostrën e urinës së pandehurit në fjalë u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të heroinës në organizmin e njeriut, prania e produkteve kanbabinoidike të metabolizmit të bimës Cannabis Sattivë dhe të metadonit në organizmin e njeriut".*

5. Këto fakte bazohen dhe rezultojnë të provuara nga: Proces verbal për kqyrjen e vendit të ngjarjes datë 17.11.2020; Proces verbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Xhiljon Hoxha e Elton Tahiri datë 17.11.2020; Procesverbal i sekuestrimit të sendeve provë materiale për shtetasin Xhiljon Hoxha datë 17.11.2020; Procesverbal përshkrimi e peshimi i provës materiale të dyshuar si lëndë narkotike të gjetur në banesën e shtetasit Xhiljon Hoxha datë 17.11.2020; Procesverbal për marrjen e urinës së shtetasit Xhiljon Hoxha datë 17.11.2020; Procesverbal i sekuestrimit të sendeve provë materiale për shtetasin Elton Tahiri datë 17.11.2020; Procesverbal përshkrimi e peshimi i provës materiale të dyshuar si lëndë narkotike të gjetur shtetasit Elton Tahiri datë 17.11.2020; Procesverbal për marrjen e urinës së shtetasit Elton Tahiri datë 17.11.2020; Akt ekspertimi kimik Nr.1270 të datës 03.02.2021; Akt ekspertimi kimik N.1633 datë 15.02.2021; Akt ekspertimit kimik Nr.1634 datë 15.02.2021; Akt ekspertimi ekspertimi toksikologjiko - ligjor Nr.2522 datë27.11.2020; Procesverbal ekspertimi toksikologjiko - ligjor Nr.2538 datë 27.11.2020; Vërtetim i gjëndjes gjyqësore të pandehurit Xhiljon Hoxha si dhe në tërësi aktet e procedimit penal nr. 8163 te vitit 2020.

5.1 I pyetur rreth akuzës, i pandehuri Xhiljon Hoxha, ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues për veprën e kryer.

6. Në këto kushte, në diskutimin përfundimtar organi i akuzës kërkoi deklarinimin fajtor të të pandehurit **Xhiljon Hoxha** për kryerjen e veprës penale të **"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve"** parashikuar nga neni **283/1** i K.Penal.

## II. Vlerësimi i gjykatës.

- Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit Xhiljon Hoxha, i akuzuar për veprën penale **"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve"**, parashikuar nga neni **283/1** i Kodit Penal.

7. Gjykata vlerëson të theksojë se ekzistenca e përgjegjesisë penale në aspektin juridik kushtëzohet nga ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale. Në këtë kuptim, në mënyrë që një subjekt të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, për të cilën akuzohet, duhet që gjykata të analizojë respektivisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të figurës së veprës penale sipas rrethanave konkrete.

8. Në çështjen objekt gjykimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit Xhiljon Hoxha për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/1 i Kodit Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: **“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”**

8.1 Në lidhje me objektin e veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**. Objekti i veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal mund të indentifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimat të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Në rastin konkret ky objekt rezulton të jetë çenuar me veprimet e kundërligjshme (të cilat do të analizohen më poshtë) të të pandehurit Xhiljon Hoxha.

8.2 Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Në kuptim të nenit 283 pg. 1 të Kodit Penal, legjislatori ka parashikuar se kjo vepër penale mund të kryhet me mënyra të ndryshme si: përmes shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo formë, transportimit, dërgimit, dorëzimit, mbajtjes, shpërndarjes, apo tregtimit në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jenë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.

8.2.1 Në çështjen konkrete, Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i

pandehuri Xhiljon Hoxha e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kështu, rezulton e provuar se i pandehuri Xhiljon Hoxha mbante në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit cannabis sativa dhe heroinë. **Nga akti i ekspertimit kimik Nr. 1270 të datës 03.02.2021** ka rezultuar se *“Pesha e të gjithë materialit bimor të përshkruar më sipër është 6,499 gram dhe materiali bimor është cannabis sativa produkt herbal i bimës” cannabis sativas L “Ndërsa sasia prej 1,892 gram materialit pluhur, tregonte për praninë e heroines”*. Gjithashtu nga kontrolli i ushtruar në pjesën tjetër të banesës, të pandehurit Xhiljon Hoxha i është sekuestruar edhe një sasi tjetër lënde narkotike. **Nga akti i ekspertimit kimik Nr. 1634 të datës 15.02.2021 ka rezultuar se:** *“Pesha e të gjitha materialit bimor të sekuestruar në ambientin tjetër të banesës e të përshkruar më sipër, i ambalazhuar në 19 paketime, është 32,6 gram dhe materiali bimor në fjalë është i llojit cannabis sativas, produkt herbal i bimës “cannabis sativas L”*. Legjislatori ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë lëndë narkotike apo psikotrope në dozë të vogël dhe për përdorim vetjak, por në rastin konkret ky parashikim nuk gjen zbatim.

**8.3 Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”,** Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale “nullum crimen, nulla poena sine culpa”, është element i përgjegjësive penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë. Për të qenë para veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë vepër penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme lënde narkotike të llojit cannabis sativa, me peshë totale 6.499 gram, 32.6 gram të amaballazhuar në 19 paketime si dhe lëndë narkotike të llojit heroinë me peshë totalë 1,892 gram.

**8.4 Në lidhje me subjektin e veprës penale.** Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri Xhiljon Hoxha ka qenë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi dhe, si i tillë, ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volutive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe ta kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

9. Në referim të analizës së mësipërme, rezulton se janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, e për pasojë gjykata vlerëson se i pandehuri Xhiljon Hoxha duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e saj.

- **Në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.**

10. Dënimi penal përfaqëson shtrëngimin shtetëror që zbatohet ndaj subjekteve të deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin, por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përsëri në të ardhmen. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij. Në vijim të këtij arsyetimi, gjykata vlerëson t'i referohet nenit 47 të K. Penal, në analizë të së cilit, kriteret për caktimin e dënimit konsistojnë në:

**i. Rrezikshmërinë e veprës penale.** Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Këtu, Gjukata thekson se paragrafi i parë i figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” përbën krim, për të cilën ligjvënasi parashikon dënimin me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet, që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjukata cmon se kjo vepër penale ka marrë një përhapje shumë të gjerë në komunitetin tonë. Prandaj, në caktimin e dënimit, Gjukata mban parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj vepre penale.

**ii. Rrezikshmërinë e autorit.** Në lidhje me këtë element gjykata duhet të ketë në konsideratë gjendjen sociale, profesionin, arsimimin, gjendjen familjare dhe atë gjyqësore. Në rastin objekt gjykimi, Gjukata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. **Së pari:** gjykata mban parasysh personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, e cila nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton i dënuar më parë. **Së dyti,** I pandehuri është i martuar, kryefamiljar me një fëmijë të mitur (10 muajsh), duke pasur përgjegjësi thelbësore për vete dhe për familjen e tij. I pandehuri e ka bashkëshorten të papunë dhe gjendja e tij familjare është aq e rënduar sa bashkëshortja pretendon se ai duhet të punojë në mënyrë që të mbështesë financiarisht familjen e tij. **Së treti:** gjykata mban parasysh moshën e të pandehurit 35 vjeç. **Së katwrti,** gjykata mban parasysh sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale. Kështu i pandehuri e pranoi faktin, gjë që tregon se është i penduar për kryerjen e veprës penale.

**iii. Shkallën e fajit.** Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjukata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Kjo për faktin, pasi i pandehuri ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh” dhe me ndërgjegje ka vepruar, duke mbajtur në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit cannabis sativa dhe heroinë me peshë totale 6.499 gram; 32.6 gram dhe 1,892 gram.

**iv. Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese.** Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë

rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Në çështjen objekt gjykimi lidhur me rrethanat lehtësuese, duke patur parasysh se në referim të nenit 49 të K. Penal ato nuk janë shterruese, gjykata vlerëson të mbajë në konsideratë faktet se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë si dhe rezulton të jetë kryefamiljar me një fëmijë të mitur. Në lidhje me rrethanat rënduese, gjykata konstaton se i pandehuri rezulton të jetë i dënuar më parë.

11. Në referim të analizës së mësipërme, gjykata vlerëson të dënojë të pandehurin Xhiljon Hoxha me 6 (gjashtë) vjet burgim për kryerjen e veprës penale “*Prodhim dhe shitje e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Xhiljon Hoxha me 4 (katër) vjet burgim.

- **Në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në prove**

12. Në zbatim të nenit 59/1 të K. Penal, i cili parashikon se: “*Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet mund të urdhëroj që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepra të tjera penale*” si dhe nenit 59/3 të K. Penal, i cili parashikon se: “*Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata*”, gjykata çmon se ekzekutimi i pjesës së mbetur të pavuajtur të dënimit (vuajtja e dënimit ka filluar në datën 17.11.2020, dita e arrestimit të të pandehurit Xhiljon Hoxha) me burgim duhet pezulluar duke e vendosur të pandehurin në një periudhë prove prej 5 (pesë) vjet me kusht, që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepra të tjera penale dhe të mbajë kontakte të rregullta me shërbimin e provës. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, si një nga alternativat e këtij lloji dënimi, çmohet i zbatueshëm në rastin në gjykim duke qenë se gjykata arriti në përfundimin se i pandehuri duhet të dënohet përfundimisht me 4 (katër) vjet burgim, duke u përmbushur në këtë mënyrë kushti se masa e dënimit për të cilin mund të aplikohet neni 59 i K. Penal është deri në 5 (pesë) vjet burgim. Po kështu, bazuar në analizën e mësipërme, gjykata vlerëson se si rrezikshmëria e veprës penale, referuar rrethanave konkrete të kryerjes së saj, ashtu edhe rrezikshmëria e vetë të pandehurit është e tillë që të justifikojë zbatimin e nenit 59 të K. Penal. Në këtë qëndrim gjykata mban parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë i martuar, me një fëmijë të mitur si dhe faktin që është kryefamiljar, duke qenë ndër të tjera në aspektin financiar dhe social, një mbështetje e rëndësishme për familjen e tij. Në vështrim edhe të parimeve kushtetuese dhe të jurisprudencës e teorisë së konsoliduar evropiane, qëllimi më i qenësishëm i dënimit penal dhe synimi final i tij është riedukimi i autorit të veprës penale dhe riintegrimi i tij në shoqëri pas kryerjes së dënimit dhe jo ndëshkimi i tij. Dënimi me burgim duhet jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet nga Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “*kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës*” dhe



duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë.

12.1 Bazuar në analizën e mësipërme, gjykata përfundimisht vlerëson se ekzekutimi i pjesës së mbetur të dënimit me burgim duhet pezulluar duke e vendosur të pandehurin në një periudhë prove prej 5 (pesë) vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepra të tjera penale dhe të mbajë kontakte të rregullta me shërbimin e provës.

- **Në lidhje me shpenzimet proceduriale**

13. Në bazë të nenit 393/1 dhe 485/3 të K. Pr. Penale, shpenzimet procedurale të fazës së hetimit, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit Xhiljon Hoxha.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 379 e vijues, nenet 403, 405, 406, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 1/c, 47- 49, 59 dhe 283/1 të Kodit Penal,

**VENDOSI:**

1. Deklarimin fajtor të pandehurit Xhiljon Hoxha për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të këtij neni me 6 (gjashtë) vjet burgim.
2. Në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale e denon përfundimisht të pandehurin Xhiljon Hoxha me 4 (kater) vjet burgim.
3. Vuajtja e dënimit ka filluar nga dita e arrestimit të tij në flagrance, dt. 17.11.2020.
4. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së mbetur përfundimisht të këtij dënimi, për një kohë prove prej 5 (pese) vjetesh, e cila fillon nga e nesërmeja e shpalljes së këtij vendimi, me kusht që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e Proves dhe gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepra penale.
5. Në bazë të nenit 60.9 të Kodit Penal detyrohet i pandehuri Xhiljon Hoxha që gjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të denuar.
6. Shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”, caktuar ndaj shtetasit Xhiljon Hoxha me vendimin nr. 1928 Akti, dt. 21.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
7. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimit paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
8. Kunder këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga njoftimi i vendimit.

**U shpall sot, në datën 30.06.2021, në Tirane.**

**SEKRETARE**

**GJYQTARE**

**Berzana**

**Armela HASANTARI**

**ÇOBO**

**Shpenzime gjyqesore**

Shpenzime te prokurorise 21000 leke

**Shpenzime ne seance paraprake**

Njoftime 150 leke

**Shpenzime ne themel**

Njoftime 150 leke